



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 6162 Prot

Shkodër, më 05.05.2020

**VENDIM**  
Nr. 103, datë 05.05.2020

**"Për miratimin e Planit të Detajuar Vendor të njësisë strukturore SH009.UB"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1 shkronja "b" dhe nenit 23, pika 14, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 5, pika 1.3, shkronja "b", nenit 13, pika 1, shkronja "dh", si dhe nenit 22, të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; nenit 72 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar; Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendim Nr.5, datë 16.10.2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit, Nismës Nr.74, datë 11.04.2019 për hartimin e PDV-së në Njësinë Strukturore SH009.UB, Akt-Përputhshmërisë datë 01.04.2020 të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si dhe Raportit Teknik të Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, Bashkia Shkodër "Mbi shqyrtimin për miratim të planit të detajuar vendor të njësisë strukturore SH009.UB",

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Planit të Detajuar Vendor për Njësinë Strukturore me Kod SH009.UB e cila kufizohet ndërmjet rrugëve: Bulevardi « Skenderbeu », rr. «At Gjergj Fishta», rr. «Marin Biçikemi».
2. Ngarkohet Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve për botimin e dokumentacionit përfundimtar të PDV-së me kod SH009.UB në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e Planit të Detajuar Vendor.
4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.



